



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 307/11 Prot.

Elbasan më, 27.01.2021

VENDIM

Nr. 7 datë 27.01.2021

***“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit,
zotit Jani Dode”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __.01.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Jani Dode”, mbështetur në nenin 54 (gërma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma “a” dhe pika 2, gërma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Ti japë titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Jani Dode, me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në fushën e arsimit si pedagog, studiues, hulumtues dhe metodist, duke reflektuar një shkallë të lartë profesionalizmi dhe duke lënë gjurmë në historikun e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si një ndër drejtuesit më të suksesshëm të saj”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

D. Kristo

